

Bazuar në nenin 8 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, nenit 4 të UA 07/2017 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik nenit 4 të Rregullores mbi Marrëdhënjen e Punës të punëtorëve të KRU “ Hidrodrini “ Sh. A. Pejë , KRU “ Hidrodrini “ Sh. A. publikon këtë :

KONKURS I BRENDSHËM

Pozita: Kryesues i Departamentit për Sherbime me Konsumatorë

I përgjigjet: Zyrtaritë të Lartë Financiar

Ekzekutues: 1(Një).

Kohëzgjatja e Kontratës: Kontrata lidhet për kohë të caktuar (6 muaj), me mundësi vazhdimi varësisht nga angazhimi i të punësuarit.

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Menaxhoj tërë departamentin
- Siguroj komunikimin dhe ndërlihdjen ndërmjet kompanisë dhe publikut (Konsumatorëve).
- Siguroj performancë të mirë të shërbimeve për publikun.
- Siguroj komunikimin me të gjitha departamentet tjera.

Më detajisht kjo përfshin:

- Organizon, kordinon ,monitoron dhe punon në Departamentin SHK.
- Pergaditë dhe ekzekuton planet vjetore/mujore/javore të aktiviteteve të SHK.
- Raporton me gojë dhe me shkrim për rezultatet e punës në Departamentin SHK.
- Kordinon punën me sektorët tjerë te kompanisë.
- Siguron nënshkrimin e kontratës në mes të klientit dhe kompanisë.
- Propozon dhe ndërmerr veprime kundër prishjeve të kontratave nga ana e konsumatorit.
- Organizon dhe mbikëqyrë procesin e faturimit.
- Organizon, monitoron procesin e inkasimit dhe pregaditë raporte mujore.
- Ndërmerr të gjitha hapat e nevojshme që të ngrisë shkallën e inkasimit.
- Monitoron për se afërmi debitorët (borgjëlinjtë) dhe ripagesat e tyre.
- Organizon punën e ekipeve të çkyqjes.
- Urdhëron ndërprerjen e furnizimit me ujë për shkelësit e kontratës dhe monitoron ekzekutimin e urdhërit.
- Organizon punën e ekipeve të inspektionit, pranon raportet e tyre dhe ndërmerr veprime të menjëhershme dhe serioze.
- Vendos dhe monitoron procedurat e trajtimit të ankesave të konsumatorit / kërkesat / aplikimet.
- Trajton dhe proceson ankesat e konsumatorëve.
- Merret me kërkesat për kyçe të reja, pregaditë dokumentacionin dhe i dorëzon ato në departamentin për kompletimin e procedurave.
- Zhvillon procesin e vetëdijesimit të popullatës.
- Pregaditë dhe ekzekuton anketa të konsumatorëve për të vlerësuar performancën dhe nivelin e kënaqësisë më shërbimet e ofruara.
- Rishikimi I nevojave për trajnim të stafit.
- Monitoron performancën e personelit dhe propozon masa koresponduese.

Kërkesat/Kualifikimet Profesionale:

- ❖ Diplomë universitare në Fakulteti Ekonomik si dhe Administrim Biznesi ;
- ❖ Punëtor i aftësuar ose i trajnuar në fushën e Menaxhimit ;
- ❖ Demonstron aftësi në të kuptuarit dhe aplikuarit të parimeve bazë të Menaxhimit;
- ❖ Dëshmi për përvojën e punës në fushën e Menaxhimit të deshmua me referencat e prezentuara;
- ❖ Tre vite përvojë pune te deshmua nga Trusti në fushën menaxheriale ;
- ❖ Kopja e letërnjoftimit;
- ❖ Çertifikatën që kandidati nuk është nën hetime;
- ❖ Letër motivimin;

Aplikacionet mund të merrenë në zyrën Burimeve Njerëzore te KRU “Hidrodrini” Sh. A. Rr” Lekë Dukagjini” Nr.156 Pejë dhe Web –faqen “ Hidrodrini” Sh. A. www.hidrodrini.com .

Aplikacionit i bashkangjiten kopje të dokumentacionit mbi kualifikimin, për përvojën e punës, dokumente tjera të nevojshme që kërkon vendi i punës për të cilën konkurrojnë kandidatët. Aplikacioni dhe dokumentet përcjellëse dorëzohen në KRU “ Hidrodrini” Sh. A. Zyra e Burimeve Njerëzore në pliko të mbyllur në adresën: Rr. “ Lekë Dukagjini” nr.156 - Pejë (afër Patrikanës së Pejës). Shpallja do të jetë e hapur 15 Ditë (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e publikimit, në shtypin ditore dhe Web –faqen www.hidrodrini.com

Kandidatët që ftohen në intervistë janë të obliguar të sjellin me vete dokumentet origjinale përverifikim para komisionit intervistues.

Kandidatët që hyjnë në përzgjedhje të ngushtë, do të informohen lidhur me intervistën nëpërmjet telefonit ose në shkrim në afat ligjor nga zyra e Burimeve Njerëzore.

Aplikacionet e dërguara pas afatit të cekur më lartë nuk do të pranohen. Dokumentat jo të kompletuara do të refuzohen, KRU “ Hidrodrini” Sh. A. ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës.